



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik KLAJGER KONSTRUKSION SHPK, me administrator Z.Sadik Lumi, me numër NIPT-i K51423028P me adresë: Tirane Kamez BATHORE Bathore 6, Kamez (Prane Kopeshtit te femijeve Bathore 6).

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”

Numri i referencës së procedures: REF-11776-11-16-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Ndërtim dhe Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në qytetin e Tiranës."

Fondi Limit: 37.159.090,55 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë presje pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjetllës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja: 90 ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit .

Data e zhvillimit të tenderit është: 03.12.2021 Ora: 09:00

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Jo

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.167 të dates 22/11/2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Arb & Trans -2010 sh.p.k NIPT-i L02325001T
Vlera: 26,011,363.40 (njëzet e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pike dyzet) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik KLAJGER KONSTRUKSION sh.p.k NIPT-i K51423028P
Vlera: 26,688,091 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” sh.p.k NIPT-i L78006801F
Vlera: 27,292,977 (njëzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik GERARD A sh.p.k NIPT-i L12407005L
Vlera: 27,723,638 (njëzet e shtatë milion e shtatëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik NDREGJONI sh.p.k NIPT-i K31329048I
Vlera: 28,774,179 (njëzet e tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
6. Operatori Ekonomik ” SIRETA 2F” sh.p.k NIPT-i K51501008J
Vlera: 28,888,888 (njëzet e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ” K.M.K” sh.p.k & ”SARDO” sh.p.k
NIPT-i L78223801E & NIPT-i K13120402W
Vlera: 28,913,109.75 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
8. Operatori Ekonomik BE-IS sh.p.k NIPT-i K71412003A
Vlera: 28,940,179 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
9. Operatori Ekonomik COMPANY RIVIERA 2008 SHPK NIPT-i K81716011V
Vlera: 29,125,136 (njëzet e nëntë milion e njëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

10. Operatori Ekonomik LEON KONSTRUKSION sh.p.k

NIPT-i K71820009I

Vlera: 31,511,998.35 (tridhjetë e një milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë pike tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

11. Operatori Ekonomik INA SHPK

NIPT-i J61814009W

Vlera: 32,618,514 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

12. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik BOE STERKAJ sh.p.k & ARJEIL sh.p.k

NIPT-i J68310708M

& NIPT-i K31320002C

Vlera: 32,645,224.5 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e njëzet e katër pikë pesë) lekë pa TVSH.

13. Operatori Ekonomik SENKA SHPK

NIPT-i J94808405Q

Vlera: (zero) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik ARB-TRANS 2010 SHPK**, me vlerë të ofertës 26,011,363.40 (njëzet e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pike dyzet) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X Neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se oferta nuk I përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë për arsye si më poshtë:

Së pari: Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.

Ujësjele Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga Kavajes Nr.133, Njesia administrative Nr.6,Kodi Postar 1027, Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

Operatori ekonomik ARB-TRANS 2010 SHPK në përmbushje të kriterit të kapacitetit teknik nuk ka paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit , në shtojcën 8 asnjë punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

Përsa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92 pika 3 Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje, të nenit 92, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu X, neni 82, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë SENKA SHPK, me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **SENKA SHPK** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 7, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **SENKA SHPK** s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", dhe të Kreut X Nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik",I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se oferta nuk I përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik KLAJGER KONSTRUKSION SHPK, me administrator Z.Sadik Lumi, me numër NIPT-i K51423028P me adresë: Tirane Kamez Bathore 6, Kamez (Prane Kopeshtit te femijeve Bathore 6), me vlerë prej 26,688,091 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.12.2021

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ELTON KACIDHJA